



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)
Datë 07.12.2020

Nr. 46 i vendimit
Datë 01.12.2022



VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.12.2022, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shpresa Beçaj, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 270, datë 03.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit Shpresa Beçaj të paraqitura në ankim, e cila përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit nr. 270, datë 03.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe pushimin e shqyrtimit të procesit të rivlerësimit në ngarkim të saj, dëgjoi gjyqtaren relatore Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR SE:

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni") , me vendimin nr. 270, datë 03.07.2020, ka vendosur, "Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë".
2. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 270, datë 03.07.2020 të Komisionit dhe pushimin e shqyrtimit të procesit të rivlerësimit në ngarkim të saj.
3. Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim "Kolegji") pasi analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe aktet shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ, arriti në përfundimet si më poshtë:

3.1. Në analizë të nenit 179/b të Kushtetutës, subjektet që duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio* sipas ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, janë të gjithë gjyqtarët. Në interpretim të dispozitave ligjore në fuqi në kohën e fitimit të të drejtave dhe kryerjes së veprimeve prej subjektit të rivlerësimit, statusi i gjyqtarit fitohet në momentin e emërimit në detyrë dhe humbet vetëm për rastet e parashikuara shprehimisht në ligj. Mbi këtë këtë arsytim dhe në bazë të provave të administruara, rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj e ka fituar statusin në momentin e emërimit në detyrë si gjyqtar, dhe e ka gëzuar pa ndërprerje gjatë dhe pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Rezulton e provuar dhe nuk është verifikuar asnjë nga rastet e mbarimit të statusit sipas parashikimeve ligjore të kohës. Për këtë arsye konkludohet që znj. Shpresa Beçaj është subjekt i ligjit nr. 84/2016 dhe duhej t'i nënshtrohej rivlerësimit *ex officio* sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, për shkak të pasjes së statusit të gjyqtarit.

3.2. Aneksi i Kushtetutës në nenet D dhe DH, dhe neni 31, pika 1, neni 35, pika 1 dhe neni 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 kanë parashikuar detyrimin ligjor të të gjithë subjekteve që përfshihen në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, për të plotësuar dhe depozituar brenda afatit të përcaktuar deklaratat e pasurisë për rivlerësim, të kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit profesional, pa pengesë apo përjashtim të subjekteve nga ky detyrim ligjor. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti që të provojë ekzistencën e rrethanave që kanë kushtëzuar mosparaqitjen e deklaratave brenda afatit të caktuar ligjor. Për rrjedhojë, mospërmbushja e detyrimit për dorëzimin e deklaratave nga subjekti i rivlerësimit Shpresa Beçaj, në referim të neneve të mësipërme të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, përbën shkak për shkarkim nga detyra.

3.3. Edhe gjatë gjykimit në Kolegji, u konstatua se subjekti i rivlerësimit Shpresa Beçaj, me sjelljen dhe veprimet e saj e ka konsideruar veten gjyqtare edhe pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ka kërkuar në vijimësi në rrugë gjyqësore të gjitha të drejtat që i takonin nga pasja e statusit të gjyqtarit. Në të njëjtën kohë subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të mos plotësojë dhe dorëzojë asnjë deklaratë në funksion të procesit të rivlerësimit brenda afatit ligjor.

4. Në përfundim, mbështetur në sa më sipër, në zbatim të neneve D dhe DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4, pikat 2 e 5, nenit 31, pika 1, neni 35, pika 1 dhe neni 41, pika 1 e



ligjit nr. 84/2016, Kolegji e gjen të bazuar në ligj e në prova vendimmarrjen e Komisionit dhe çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që nuk duhet t'i nënshtrohej këtij procesi nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,


trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 270, datë 03.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpresa Beçaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 01.12.2022.

ANËTARE


Albana SHTYLLA

ANËTAR


Sokol ÇOMO

ANËTARE


Ina RAMA

RELATORE


Mimoza TASI

KRYESUESE


Rezarta SCHUETZ

